

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “G&M 24” SH.P.K.

Neni 1

Formimi

Sot me datë 28.01.2025 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “G&M 24” SH.P.K.

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Gerti Domazet**, i datëlindjes 22.10.1994, lindur në Grace dhe banues në Tiranë,

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “G&M 24” SH.P.K. është në adresën: **Rruga Astrit Losha, Pallati Marituda, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 300/142, Kati i pare, Dyqani Nr. 15, Kashar, Tiranë.**

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “G&M 24” SH.P.K. është e pacaktuar.

Neni 4

Objekti Veprimtarisë

1. Te jape dhe marre makina me qira (Rent a Car)
2. Te bleje dhe te shese makina
3. Te shese bleje pasuri te paluajtshme
4. Te sherbeje si agent imobiliar
5. Te marre dhe jape prona me qira
6. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.



7. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë **“G&M 24” SH.P.K.** është 100.000 (Njeqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuote si vijon:

1. **Gerti Domazet** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njeqind mijë) Lekë që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Organet e Shoqërise dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë **“G&M 24” SH.P.K.** janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administrator i shoqërisë, është **Z.Gerti Domazet**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Gerti Domazet**, si administrator i saj, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t’a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“G&M 24” SH.P.K.** në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria **“G&M 24” SH.P.K.** njihet si person juridik.

Neni 10



1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërisë i japin të drejtën **Z.Armand Shkurta**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjetër për regjistrimin e shoqërisë **“G&M 24” SH.P.K.**

ORTAKET THEMELUES I SHOQERISE

Gerti Domazet

